



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË

RAPORT

MBI STATUSIN E VËSHTIRËSISË FINANCIARE TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE/ BASHKI

2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE
DHE EKONOMISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCEVE VENDORE

RAPORT

MBI STATUSIN E

VËSHTIRËSISË FINANCIARE

TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES

VENDORE/ BASHKI

VITI 2021

Ky raport është përgatitur me mbështetjen e projektit 'Financat Lokale' nga Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike SECO

FINANCATLOKALE | Forcimi i Menaxhimit
LOCALFINANCES | të Financave Publike
të Qeverisjes Vendore



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike, SECO

PËRMBAJTJA

Përmbledhje e gjetjeve kryesore.....	7
Hyrje.....	10
Metodologjia dhe mbledhja e të dhënave	11
Analiza mbi treguesit e përgjithshëm të detyrimeve të prapambetura të bashkive.....	12
Detyrimet e prapambetura dhe fondet e trashëguara nga viti 2021.....	24
Konkluzione/ rekomandime.....	33
Konkluzione	33
Rekomandime	36
Plani i shlyerjes së detyrimeve.....	39
Analiza e detajuar mbi treguesit e detyrimeve të prapambetura për secilën bashki.....	40
Bashkia Belsh.....	40
Bashkia Berat.....	42
Bashkia Bulqizë.....	44
Bashkia Cërrik.....	46
Bashkia Delvinë.....	48
Bashkia Devoll.....	50
Bashkia Dibër.....	52
Bashkia Dimal.....	54
Bashkia Divjakë.....	56
Bashkia Dropull.....	58
Bashkia Durrës.....	60
Bashkia Elbasan.....	62
Bashkia Fier.....	64
Bashkia Fushë Arrëz.....	68
Bashkia Gramsh.....	70
Bashkia Gjirokastrë.....	72
Bashkia Has.....	74
Bashkia Himarë.....	76
Bashkia Kamëz.....	78
Bashkia Kavajë.....	80
Bashkia Këlcyre.....	82
Bashkia Klos.....	84
Bashkia Kolonjë.....	86
Bashkia Konispol.....	88
Bashkia Korçë.....	90
Bashkia Krujë.....	92
Bashkia Kuçovë.....	94
Bashkia Kukës	96
Bashkia Kurbin.....	98
Bashkia Lezhë.....	100
Bashkia Libohovë.....	102
Bashkia Librazhd.....	104
Bashkia Lushnje.....	106
Bashkia Malësi e Madhe.....	108
Bashkia Maliq.....	110

Bashkia Mallakastër.....	112
Bashkia Mat.....	114
Bashkia Memaliaj.....	116
Bashkia Mirditë.....	118
Bashkia Patos.....	120
Bashkia Peqin.....	121
Bashkia Përmet.....	123
Bashkia Pogradec.....	125
Bashkia Poliçan.....	127
Bashkia Pukë	131
Bashkia Pustec	133
Bashkia Roskovec.....	135
Bashkia Rrogozhinë.....	137
Bashkia Sarandë.....	139
Bashkia Selenicë	141
Bashkia Skrapar.....	143
Bashkia Shijak	145
Bashkia Shkodër	147
Bashkia Tepelenë	149
Bashkia Tiranë.....	151
Bashkia Tropojë.....	153
Bashkia Vau i Dejës.....	155
Bashkia Vlorë.....	157
Bashkia Vorë.....	159

PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE

Raporti i konsoliduar është përgatitur nga Drejtoria e Financave Vendore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me mbështetjen e ekipit të projektit “Financat Lokale”¹, mbi bazën e të dhënave të raportuara nga bashkitë e vendit, të dhënave të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë dhe në funksion të zbatimit të udhëzimit nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” (pika 2/i) për implementimin e një sistemi monitorimi për të identifikuar njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat përballen me probleme financiare, vështirësi financiare, vështirësi serioze financiare apo paaftësi paguese. Të dhënat pasqyrojnë detyrimet për 61 bashki.

Stoku i detyrimeve financiare të prapambetura deri në fund të dhjetorit të vitit 2021 për njësitë e vetëqeverisjes vendore është 6.5 miliardë lekë (6,463,655,523 lekë). Nisur nga impakti financiar në detyrimet financiare të qeverisjes së përgjithshme, një vëmendje të vecantë merr (i) rëndësia që menaxhimi i lartë i bashkive duhet t’i kushtojë menaxhimit të detyrimeve financiare të prapambetura dhe kujdesit në marrjen përsipër të angazhimeve financiare të reja, si dhe (ii) domosdoshmëria e monitorimit të ngushtë deri në kontroll direkt të angazhimeve publike që duhet të ushtrojë Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkitë që rezultojnë me vështirësi financiare deri në paaftësi paguese.

Statusi Financiar i Bashkive në fund të vitit 2021 (kundrejt shpenzimeve vjetore të planifikuara)

Nr. i Bashkive	% e detyrimeve të prapambetura ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara 2021	Situata Financiare e fundvitit 2021
44 Bashki	Nga 0 deri 15 %	Pa probleme financiare
10 Bashki	Nga 16% deri 25%	Me probleme financiare
7 Bashki	Nga 26% deri 80%	Në vështirësi financiare

Vlerësime dhe Problematika

Referuar analizës sipas bashkive konstatohet se, në vitin 2021 **shtatë bashki kanë një status si njësi në vështirësi financiare**, konkretisht bashkitë: Roskovec, Poliçan, Cërr-ik, Malësi e Madhe, Vorë, Belsh e Kavajë. **Dhjetë bashki kanë probleme financiare, konkretisht bashkitë:** Peqin, Tropojë, Tepelenë, Rogozhinë, Konispol, Lezhë, Kuçovë, Pogradec, Delvinë e Dimal. 44 bashki të tjera nuk kanë probleme financiare.

Përmendim veçanërisht për një performancë shumë të mirë financiare gjatë vitit 2021, bashkitë Gjirokastër, Patos, Këlcyre, Shkodër, Korçë me stok më të vogël se 1% të detyrimeve

1. Projekti “Financat Lokale” financohet nga Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike, SECO

të prapambetura përkundrejt shpenzimeve të planifikuara, si dhe për një performance të mirë 39 bashkitë e tjera ku veçojmë bashkitë e mëdha si Tirana, Elbasani dhe Vlora me stok më të vogël se 5% të detyrimeve të prapambetura përkundrejt shpenzimeve të miratuara. Vihet re se bashkitë që demonstrojnë probleme financiare apo janë në vështirësi financiare janë më së shumti bashkitë me shpenzime të planifikuara për frymë për vitin 2021 nën mesataren prej 21,306 lekë për banorë.

41 bashki e kanë ulur stokun e detyrimeve të prapambetura në 2021 krahasuar me 2020. Bashkia e Këlcyrës, Vorës, Dimal, Poliçanit dhe Tepelenës kanë përmirësuar statusin e vështirësisë financiare në 2021, duke reduktuar stokun e detyrimeve të prapambetura më shumë se me 10%. Bashkia e Këlcyrës rezulton nga një bashki në vështirësi financiare në një bashki pa probleme financiare me asnjë detyrim të prapambetur. Nëntë bashki të tjera kanë përmirësuar statusin e tyre përmes një reduktimi të detyrimeve të prapambetura me më shumë se 5%. Bashkia e Dibrës, Kukësit dhe Finiqit në tre vitet e fundit kanë përmirësuar statusin nga bashki me vështirësi financiare në bashki pa probleme financiare. Bashkia e Pogradecit ka përmirësuar statusin nga bashki në vështirësi financiare në bashki me probleme financiare. Stoku i detyrimeve është reduktuar me më pak se 5% për 26 bashki të tjera.

16 bashki e kanë rritur përqindjen e stokut të detyrimeve në 2021. Për 12 bashki stoku i detyrimeve të prapambetura është rritur me deri 5% dhe për Bashkinë e Maliqit stoku është rritur me 6%. Statusi i vështirësisë financiare është përkeqësuar për bashkinë e Roskovecit dhe të Peqinit duke u klasifikuar si bashki në vështirësi financiare në 2021. Stoku i detyrimeve financiare është rritur më shumë se 10% për tre bashki. Statusi i vështirësisë financiare është përkeqësuar për Bashkinë e Cërrikut nga një bashki me probleme financiare në një bashki në vështirësi financiare. Statusi i vështirësisë financiare është përkeqësuar shumë për Bashkinë e Belshit nga një bashki pa probleme financiare në 2019 në një bashki në vështirësi financiare me rritje të ndjeshme nga viti 2020. Gjithashtu, statusi i vështirësisë financiare është përkeqësuar edhe për bashkinë Malësi e Madhe nga një bashki pa probleme financiare në 2020 në një bashki me vështirësi financiare në 2021.

Në lidhje me strukturën e detyrimeve të prapambetura, vihet re se rreth 9% janë të natyrës së vendimeve gjyqësore, 56% e tyre janë të natyrës së shpenzimeve për investime dhe rreth 35% janë për shpenzime të tjera korrente. Në dallim nga viti 2020, vihet re një reduktim të detyrimeve për vendime gjyqësore dhe rritje e detyrimeve të natyrës së shpenzimeve të tjera korrente.

Shumica e bashkive me detyrime mbi 15% ndaj shpenzimeve vjetore të miratuara kanë më shumë detyrime të natyrës së shpenzimeve kapitale, me përjashtim të bashkive të Tepelenës, Konispolit, Lezhës, Pogradecit dhe Kavajës. Bashkia e Pogradecit ka përqindjen më të lartë të detyrimeve për vendime gjyqësore (31.14%), edhe pse të përgjysmuar nga treguesi në vitin 2020 (65.27%). Bashkia e Lezhës gjithashtu ka shlyer pjesën më të madhe të detyrimeve të vendimeve gjyqësore, nga 38.09% në 2020, në 0.37% në 2021.

Nëse do të vlerësonim situatën e detyrimeve të prapambetura të bashkive **përkundrejt shpenzimeve faktike të vitit 2021, vihet re një përkeqësim i treguesit të detyrimeve.** Mesatarisht buxheti realizohet në masën prej 75.56% dhe 28 bashki kanë një tregues të realizimit të buxhetit nën mesatare. Në këto kushte, stoku i detyrimeve të prapambetura përkundrejt buxhetit të realizuar rritet.

Statusi financiar i Bashkive në fund të vitit 2021 (kundrejt shpenzimeve vjetore faktike)

Nr. i Bashkive	% e detyrimeve të prapambetura ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara 2021	Situata Financiare e fundvitit 2021
35 Bashki	Nga 0 deri 15 %	Pa probleme financiare
14 Bashki	Nga 16% deri 25%	Me probleme financiare
10 Bashki	Nga 26% deri 80%	Në vështirësi financiare
2 Bashki	Nga 81% deri 130%	Në vështirësi serioze financiare

Situata në Bashkinë e Kavajës dhe të Vorës është shumë më serioze ku detyrimet e prapambetura shënojnë respektivisht 91.23% dhe 90.54% të shpenzimeve faktike në vitin 2021. Në këto kushte, bashkitë duhet t'i vlerësojnë me kujdes angazhimet e reja financiare në kushtet e ritmeve të ulta të ekzekutimit të buxhetit.

Në bazë të raportimeve të bashkive, rezulton se ka një plan shlyerje të detyrimeve të prapambetura për shumicën e bashkive. **Planet për shlyerjen e detyrimeve duhet të rishihen nga bashkitë dhe të jenë në përputhje me shumën e detyrimeve të prapambetura të gjeneruara nga raporti i Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë.** Kështu, 14 bashki: Bashkitë e Belshit, Beratit, Cërrikut, Dimalit, Durrësit, Fierit, Gramshit, Kavajës, Kucovës, Librazhdit, Malësisë së Madhe, Mirditës, Pukës dhe Roskovecit figurojnë në Sistemin Informacionit Financiar Qeveritar me detyrime më të mëdha nga ato të raportuara. Përkatësisht, **plani i shlyerjes për një total detyrimesh prej 2.8 miliardë lekë duhet të rishihet.**

Ndërsa të gjitha bashkitë e tjera **planifikojnë të shlyejnë detyrimet sipas skedulit: 51% në vitin 2022, 22% në vitin 2023 dhe 14% në vitin 2024.**

Për vitin 2022, fondet e trashëguara nga bashkitë rezultojnë kryesisht nga të ardhurat e veta dhe nga transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale e papërdorur gjatë vitit 2021. **Mbartja e fondeve të papërdorura nga viti 2021 për vitin 2022, në një vlerë të konsiderueshme rreth 20 miliard lekë tregon një dobësi në menaxhimin e fondeve publike vendore brenda vitit fiskal.**

Konstatohet se në vlerë absolute bashkia Tiranë trashëgon pjesën më të lartë të fondeve rreth 10.6 miliard lekë, më pas vjen bashkia Durrës rreth 1 miliard lekë, bashkia Shkodër 816 milion lekë, bashkia Himarë 584 milion lekë, bashkia Fier 465 milion lekë. Por, **bashkia e Himarës ka nivelin më të lartë të fondeve të papërdorura në 43 milionë lekë për 1,000 banorë, ndjekur nga Tirana në 16.6 milionë lekë për 1,000 banorë.** Mesatarja e fondeve të papërdorura është 5.1 milionë lekë për 1,000 banorë dhe vetëm 8 bashki janë mbi këtë mesatare: bashkitë e Gjirokastrës, Malësisë së Madhe, Krujës, Malësisë së Madhe, Mallakastrës, Sarandës, Shkodrës dhe Tiranës.

Nëse do të vëzhgonim vetëm **bashkitë me status vështirësie me probleme dhe në vështirësi financiare, vihet re se mesatarisht fondet e trashëguara janë 42% të totalit të detyrimeve të prapambetura.** Të gjitha bashkitë do kishin përmirësuar statusin e tyre të vështirësisë nëse do ishin përdorur fondet në dispozicion. Kështu lind e domosdoshme identifikimi i debitorëve dhe ndjekja e procedurave të mënjëhershme për reduktimin dhe shlyerjen e detyrimeve nga të gjitha bashkitë dhe vecanërisht në ato me status vështirësie me probleme e vështirësi financiare.

HYRJE

Në mbështetje të neneve 57 dhe 59 të ligjit nr. 68, datë 17.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ministri i Financave dhe Ekonomisë lëshoi Udhëzimin nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”. Ky raport përgatitet në funksion të qëllimit të udhëzimit (pika 2/i) për implementimin e një sistemi monitorimi për të identifikuar njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat përballen me probleme financiare, vështirësi financiare, vështirësi serioze financiare apo paaftësi paguese.

Në tabelën nr. 1 paraqiten kriteret e klasifikimit për secilin nga nivelet e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Tabela nr.1 Rastet e njësive të vetëqeverisjes vendore me vështirësi financiare

Nr	Rastet	Kriteret e Klasifikimit
1	Probleme financiare (neni 55)	(i) Detyrimet financiare të konstatuara dhe papaguara të NJVQVQV-së, ndaj palëve të treta përbëjnë 15 përqind të shpenzimeve vjetore të miratuara, në një muaj të caktuar; (ii) Detyrimet financiare të konstatuara dhe të papaguara të NJVQVQV-së, ndaj palëve të treta tejkalojnë 20 përqind të shpenzimeve vjetore të miratuara në muajin pasues.
2	Vështirësia financiare (Neni 56)	Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet në vështirësi financiare kur vonesat në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta konstatohen edhe në muajin pasues të muajit kur tejkalon nivelin prej 20 përqind, dhe vlera e stokut rritet progresivisht mbi nivelin prej 25 përqind të shpenzimeve vjetore të miratuara.
3	Vështirësia serioze financiare (Neni 57)	Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet në vështirësi serioze financiare, kur borxhet afatgjata dhe detyrimet e papaguara ndaj palëve të treta përbëjnë mbi 80 përqind të shpenzimeve vjetore të miratuara.
4	Papaftësia paguese (Neni 59)	Kur njësia e vetëqeverisjes vendore nuk arrin të zbatojë planin e rehabilitimit financiar dhe / ose shuma e borxheve afatgjata të NJVQVQV-së dhe detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta është më e lartë se 130 përqind të shpenzimeve vjetore të miratuara.

METODOLOGJIA DHE MBLEDHJA E TË DHËNAVE

Për hartimin e këtij raporti, Drejtoria e Financave Vendore ka mbledhur informacion nga Bashkitë sipas formës tabelare në Aneksin 1 dhe Aneksin 2 të Udhëzimit nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

Informacioni financiar është dorëzuar nga të gjitha bashkitë, por konstatojmë se për një pjesë të bashkive vlera e detyrimeve financiare të prapambetura të raportuara për vitin 2021, nuk përputhet me informacionin e gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ). Vetëm një pjesë e bashkive kanë argumentuar këto mospërputhje dhe janë të angazhuara për zgjidhjen e kësaj problematike në raportimet në vijim.

Gjithashtu, në raportimet e bashkive, të dhënat mbi totalin e shpenzimeve të miratuara përputhen me të dhënat e SIFQ vetëm për katër bashki. Për 24 bashki, totali i raportuar i shpenzimeve të miratuara është më i vogël se ai në SIFQ, dhe për 33 bashki totali i raportuar i shpenzimeve të miratuara është më i madh se ai në SIFQ.²

Bazuar në problematikat e raportimit të bashkive si më sipër, të dhënat financiare mbi bazën e të cilave është llogaritur statusi financiar i bashkive në këtë raport janë ato të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë.

Raporti është përgatitur nga Drejtoria e Financave Vendore me mbështetjen e projektit të financuar nga Ambasada Zvicerane në Shqipëri, SECO për “Financat Lokale”.

ANALIZA MBI TREGUESIT E PËRGJITHSHËM TË DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË BASHKIVE

Stoku i detyrimeve financiare të prapambetura deri në dhjetor 2021 për njësitë e vetëqeverisjes vendore-bashki është rreth 6.5 miliardë lekë (6,463,655,523 lekë), rreth 8.7% e totalit të shpenzimeve vjetore të miratuara (planifikuara) nga secila bashki. Të dhënat pasqyrojnë detyrimet për të gjitha 61 bashkitë. Në krahasim me vitin 2020, kemi një reduktim në vlerë absolute të detyrimeve të prapambetura prej rreth 400 milionë lekë dhe një rënie të mesatares së treguesit të detyrimeve të prapambetura në përqindje të shpenzimeve të planifikuara për secilën bashki, nga 14.54% në vitin 2020 në 12.9% në 2021.

Për një vlerësim më koherent të performancës financiare të bashkive, në këtë seksion paraqitet në mënyrë të përmbledhur gjëndja financiare e bashkive në dy nivele:

- detyrimet financiare të prapambetura kundrejt shpenzimeve vjetore të planifikuara (Tabela 2)
- detyrimet financiare të prapambetura kundrejt shpenzimeve vjetore faktike (Tabela 8), e cila orienton vendimmarrjen për trajtimin e problematikave aktuale dhe marrjen e angazhimeve të reja financiare në kushtet e ritmeve të ulta të ekzekutimit të buxhetit.

Situata financiare vlerësuar kundrejt shpenzimeve vjetore të planifikuara

Shtatë bashki vlerësohen në vështirësi financiare, ku Bashkia e Kavajës ka një stok të detyrimeve të prapambetura në nivelin e 68.05% të shpenzimeve vjetore të miratuara, dhe Bashkia e Belshit në nivelin e 61.43% të shpenzimeve vjetore të miratuara (Tabela nr. 2). Dhjetë bashki kanë probleme financiare, ndërsa të 44 bashkitë e tjera nuk kanë probleme financiare.

Përmendim veçanërisht për një performancë shumë të mirë financiare bashkitë Gjirokastër, Patos, Këlcyrë, Shkodër, Korçë me stok më të vogël se 1% të detyrimeve të prapambetura përkundrejt shpenzimeve të planifikuara, si dhe për një performancë të mirë 39 bashkitë e tjera ku veçojmë bashkitë e mëdha si Tirana, Elbasani dhe Vloa me stok më të vogël se 5% të detyrimeve të prapambetura përkundrejt shpenzimeve të planifikuara.


Tabela nr.2 Statusi i vështirësisë financiare për Bashkitë 2021 (referuar shpenzimeve të planifikuara)

Statusi i Vështirësisë	Nr. i Bashkive	Bashkia	Detyrime të prapambetura	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara 2021
Pa Probleme Financiare	44	Të gjitha bashkitë e tjera		
Me Probleme Financiare	10	Peqin (PQN)	63,858,679	16.83%
		Tropojë (TRP)	77,234,977	16.94%
		Tepelenë (TPL)	39,180,517	17.53%
		Rrogozhinë (RRGZH)	93,866,290	18.23%
		Konispol (KNS)	35,329,998	20.12%
		Lezhë (LZH)	278,568,031	21.61%
		Kuçovë (KCV)	124,173,478	22.14%
		Pogradec (PGR)	320,637,177	22.23%
		Delvinë (DLV)	51,449,232	25.30%
		Dimal (DML)	133,509,042	25.34%
Në Vështirësi Financiare	7	Roskovec (RSK)	175,882,374	25.80%
		Poliçan (PLC)	78,602,845	31.46%
		Cërrik (CRRK)	181,333,663	41.18%
		Malësi e Madhe (MLM)	322,781,244	51.83%
		Vorë (VR)	515,591,777	53.13%
		Belsh (BLSH)	214,543,511	61.43%
		Kavajë (KVJ)	820,048,291	68.05%

Burimi: Raportimet e Bashkive 2021 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe të dhënat e SIFQ



Grafiku nr.1 pasqyron stokun e detyrimeve financiare të prapambetura për të gjitha bashkitë. Mesatarja e detyrimeve të prapambetura në mes bashkive është 12.9%.

Grafiku nr.1 Detyrimet e prapambetura Dhjetor 2021 në përqindje të shpenzimeve të miratuara 2021



Burimi: Raportimet e Bashkive 2021 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe të dhënat e SIFQ


Hartat e mëposhtme tregojnë vizualisht evolucionin e statusit të vështirësishë financiare nga viti 2020 në vitin 2021.



Grafiku nr. 2 pasqyron pozicionimin e bashkive sipas përqindjes së detyrimeve të prapambetura ndaj shpenzimeve të miratuara 2021 përkundrejt shpenzimeve të miratuara për frymë të vitit 2021. Për përlogaritjen e shpenzimeve të miratuara për frymë, për treguesin e pullsisë është marrë vlerësimi i përlogaritur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bazë të të dhënave të regjistrit civil nga Gjendja Civile dhe të dhënat e Censurit 2011. Ky tregues popullsie është përdorur edhe në përlogaritjen e transferit të pakushtëzuar për buxhetin e vitit 2021. Shpenzimet e miratuara për frymë variojnë nga 12,105 lekë për banor në Bashkinë e Kurbinit në 70,771 lekë për banor në Bashkinë e Himarës dhe mesatarja mes 61 bashkive është 21,306 lekë për banor.

Nga grafiku del qartë se pjesa më e madhe bashkive me probleme e vështirësi financiare gjenden nën mesataren e shpenzimeve të miratuara për banorë.

Grafiku nr.2 Shpenzimet e miratuara për frymë 2021 vs përqindjen e detyrimeve të prapambetura ndaj Shpenzimeve të miratuara



Krahasuar me statusin e detyrimeve në vitin 2020, gjashtë bashki rezultojnë të kenë reduktuar stokun më shumë se me 10% (Tabela nr.3). Bashkia e Këlcyrës, Vorës, Dimalit, Poliçanit dhe Tepelenës kanë përmirësuar statusin e vështirësisë financiare në vitin 2021. Bashkia e Këlcyrës rezulton nga një bashki në vështirësi financiare në një bashki pa probleme financiare me asnjë detyrim të prapambetur. Nëntë bashki të tjera kanë përmirësuar statusin e tyre përmes një reduktimi të stokut me më shumë se 5%. Bashkia e Dibrës, Kukësit dhe Finiqit në tre vitet e fundit kanë përmirësuar statusin nga bashki me vështirësi financiare në bashki pa probleme financiare. Bashkia e Pogradecit ka përmirësuar statusin nga bashki në vështirësi financiare në bashki me probleme financiare.

Tabela nr.3 Reduktimi i Stokut me më Shumë se 5% për Bashkitë për 2021-2020

Nr.	Bashkia	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara 2021	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara 2020	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara 2019	Niveli i ndryshimit 2021-2020
1	Këlcyrë (KLC)	0.00%	28.84%	1.47%	Reduktim > 10%
2	Vorë (VR)	53.13%	74.76%	1.78%	
3	Poliçan (PLC)	31.46%	47.10%	41.94%	
4	Korçë (KRC)	0.62%	12.87%	2.56%	
5	Kurbin (KRB)	2.99%	13.58%	11.79%	
6	Tepelenë (TPL)	17.53%	27.99%	31.81%	
1	Dibër (DBR)	15.34%	24.88%	37.04%	Reduktim 5-10%
2	Kukës (KKS)	13.63%	23.11%	44.13%	
3	Pogradec (PGR)	22.23%	31.42%	35.89%	
4	Himarë (HMR)	2.88%	10.68%	4.34%	
5	Finqi (FNQ)	14.73%	22.13%	32.79%	
6	Vlorë (VLR)	4.46%	11.31%	13.10%	
7	Has (HS)	5.81%	11.56%	9.59%	
8	Tropojë (TRP)	16.94%	22.40%	24.44%	
9	Selenicë (SLN)	13.18%	18.51%	18.42%	

Burimi: Raportimet e Bashkive 2021 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe të dhënat e SIFQ

Stoku i detyrimeve është reduktuar me më pak se 5% për 26 bashki të tjera dhe për Bashkinë e Patosit nuk ka pësuar ndryshim (0%).

Ndërkohë për 12 bashki stoku i detyrimeve është rritur me deri 5% dhe për Bashkinë e Maliqit stoku është rritur me 6%. Statusi i vështirësisë financiare është përkeqësuar për bashkinë e Roskovecit dhe të Peqinit duke u klasifikuar si bashki në vështirësi financiare në 2021 (Tabela nr. 4).

Tabela nr.4 Rritja e Stokut deri me 10% për Bashkitë, 2021-2020

Nr.	Bashkia	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara 2021	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara 2020	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara 2019	Niveli i ndryshimit 2021-2020
1	Roskovec (RSK)	25.80%	25.29%	21.53%	Rritje 1-5%
2	Skrapar (SKR)	8.12%	7.60%	11.83%	
3	Elbasan (ELB)	3.96%	3.05%	6.15%	
4	Dropull (DRP)	0.96%	0.00%	1.55%	
5	Berat (BRT)	13.63%	12.63%	12.79%	
6	Dimal (DML)	25.34%	23.56%	45.82%	
7	Delvinë (DLV)	25.30%	22.53%	12.26%	
8	Gramsh (GRM)	5.05%	1.64%	3.21%	
9	Pukë (PK)	14.39%	10.54%	12.26%	
10	Durrës (DRRS)	8.52%	4.21%	6.82%	
11	Fier (FR)	8.76%	3.86%	5.20%	
12	Peqin (PQN)	16.83%	11.74%	14.91%	
1	Maliq (MLQ)	7.41%	1.38%	9.02%	Rritje 5-10%

Burimi: Raportimet e Bashkive 2021 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe të dhënat e SIFQ

Stoku i detyrimeve financiare është rritur më shumë se 10% për tre bashki. Statusi i vështirësisë financiare është përkeqësuar për Bashkinë e Cërrikut nga një bashki me probleme financiare në një bashki në vështirësi financiare. Statusi i vështirësisë financiare është përkeqësuar shumë për Bashkinë e Belshit nga një bashki pa probleme financiare në 2019 në një bashki në vështirësi financiare me rritje të ndjeshme nga viti 2020. Gjithashtu, statusi i vështirësisë financiare është përkeqësuar edhe për bashkinë Malësi e Madhe nga një bashki pa probleme financiare në vitin 2020 në një bashki me vështirësi financiare në vitin 2021 (Tabela nr. 5). Bashkia Malësi e Madhe në raportimin e saj ka sqaruar se një pjesë e madhe detyrimeve të pasqyruara në SIFQ vjen nga si rrjedhojë e detyrimeve të akumuluar nga financimi I FSHZH-së për ujësjellësin. Bashkia Cërrik dhe Bashkia Belsh kanë raportuar që një pjesë e detyrimeve vjen nga mungesa e financimit të projekteve të financuara nga ministritë e linjës.


Tabela nr.5 Rritja e Stokut mbi 10% për Bashkitë, 2021-2020

Nr.	Bashkia	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara 2021	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara 2020	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara 2019	Niveli i ndryshimit 2021-2020
1	Cërrik (CRRK)	41.18%	17.52%	21.01%	Rritje >10%
2	Belsh (BLSH)	61.43%	29.68%	15.25%	
3	Malësi e Madhe (MLM)	51.83%	8.75%	2.97%	

Burimi: Raportimet e Bashkive 2021 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe të dhënat e SIFQ

Grafiku nr. 3 pasqyron diferencën 2021-2020 të përqindjes së detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara. 16 bashki e kanë rritur përqindjen e stokut të detyrimeve në 2021, 41 bashki e kanë ulur dhe Bashkia e Patosit nuk ka pësuar ndryshim (0%). Bashkia e Malësisë së Madhe shënon rritjen më të madhe prej 43.08% në 2021 të përqindjes së stokut të detyrimeve të prapambetura nga viti 2020.

Grafiku nr.3 Diferenca 2020-2021 e Përqindjes së detyrimeve të prapambetura ndaj shpenzimeve të miratuara



Burimi: Raportimet e Bashkive 2021 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe të dhënat e SIFQ

Në lidhje me strukturën e detyrimeve të prapambetura, vihet re se rreth 9% janë të natyrës së vendimeve gjyqësore, 56% e tyre janë të natyrës së shpenzimeve për investime dhe rreth 35% janë për shpenzime të tjera korrente. Në dallim nga viti 2020, vihet re një reduktim të detyrimeve për vendime gjyqësore dhe rritje e detyrimeve të natyrës së shpenzimeve të tjera korrente. Ndërkohë, përqindja mesatare mes bashkive për detyrime të natyrës së vendimeve gjyqësore është rreth 14%, për shpenzime të tjera korrente është 33% dhe për investime është 53% (Tabela nr. 6).

Tabela nr.6 Struktura e Detyrimeve të Prapambetura 2021

Natyra e detyrimeve	Vlera	Përqindja ndaj totalit të detyrimeve 2021	Përqindja ndaj totalit të detyrimeve 2020*	Përqindja mesatare mes bashkive
Vendime Gjyqësore	572,811,506	8.86%	11.78%	13.68%
Shpenzime Korrente	2,277,894,114	35.24%	26.49%	33.42%
Shpenzime Kapitale	3,612,949,903	55.90%	61.73%	52.90%
Totali	6,463,655,523			

*Në bazë të një raportimi të 21 bashkive në 2020.

Burimi: Raportimet e Bashkive 2021 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe të dhënat e SIFQ

Tabela nr. 7 pasqyron strukturën e detyrimeve të prapambetura për të gjitha bashkitë me detyrime më të larta se 15% të shpenzimeve të miratuara.

Shumica e bashkive me detyrime mbi 15% ndaj shpenzimeve të miratuara kanë më shumë detyrime të natyrës së shpenzimeve kapitale, me përjashtim të bashkive të Tepelenës, Konispolit, Lezhës, Pogradecit dhe Kavajës. Bashkia e Pogradecit ka përqindjen më të lartë të detyrimeve për vendime gjyqësore (31.14%), edhe pse të përgjysmuar nga treguesi në vitin 2020 (65.27%). Bashkia e Lezhës gjithashtu ka shlyer pjesën më të madhe të detyrimeve të vendimeve gjyqësore, nga 38.09% në 2020, në 0.37% në 2021.

Tabela nr.7 Struktura e detyrimeve të prapambetura, dhjetor 2021

Statusi i Vështirësisë	Bashki	Vendime Gjyqësore		Të tjera korrente		Investime		Totali
		Vlera	Përqindja	Vlera	Përqindja	Vlera	Përqindja	
Probleme Financiare	Peqin (PQN)	10,311,904	16.15%	26,280,709	41.15%	27,266,066	42.70%	63,858,679
	Tropojë (TRP)	6,730,584	8.71%	3,574,046	4.63%	66,930,347	86.66%	77,234,977
	Tepelenë (TPL)	924,999	2.36%	33,272,289	84.92%	4,983,229	12.72%	39,180,517
	Rrogozhinë (RRGZH)	250,000	0.27%	16,011,152	17.06%	77,605,138	82.68%	93,866,290
	Konispol (KNS)	0	0.00%	33,691,792	95.36%	1,638,206	4.64%	35,329,998
	Lezhë (LZH)	1,022,164	0.37%	192,215,382	69.00%	85,330,485	30.63%	278,568,031
	Kuçovë (KCV)	0	0.00%	5,847,215	4.71%	118,326,263	95.29%	124,173,478
	Pogradec (PGR)	99,850,193	31.14%	144,968,414	45.21%	75,818,570	23.65%	320,637,177
	Delvinë (DLV)	1,948,428	3.79%	10,402,690	20.22%	39,098,114	75.99%	51,449,232
	Dimal (DML)	15,640,021	11.71%	49,532,830	37.10%	68,336,191	51.18%	133,509,042
Vështirësi Financiare	Roskovec (RSK)	0	0.00%	12,417,753	7.06%	163,464,621	92.94%	175,882,374
	Poliçan (PLC)	8,672,439	11.03%	23,729,480	30.19%	46,200,926	58.78%	78,602,845
	Cërrik (CRRK)	426,000	0.23%	9,117,143	5.03%	171,790,520	94.74%	181,333,663
	Malësi e Madhe (MLM)	4,902,366	1.52%	567,600	0.18%	317,311,278	98.31%	322,781,244
	Vorë (VR)	7,509,389	1.46%	87,647,687	17.00%	420,434,701	81.54%	515,591,777
	Belsh (BLSH)	0	0.00%	1,180,817	0.55%	213,362,694	99.45%	214,543,511
	Kavajë (KVJ)	60,528,411	7.38%	617,787,853	75.34%	141,732,027	17.28%	820,048,291
	Mesatarja mes bashkive		13.68%		33.42%		52.90%	

Burimi: Raportimet e Bashkisë 2021 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe të dhënat e SIFQ

Situata financiare e bashkive vlerësuar kundrejt shpenzimeve vjetore faktike

Nëse do të vlerësonim situatën e detyrimeve të prapambetura të bashkive përkundrejt shpenzimeve faktike të vitit 2021, vihet re një përkeqësim i treguesit të gjëndjes financiare në disa bashki (Grafiku nr. 4). Treguesi i realizimit të buxhetit nga bashkitë për vitin 2021 varion nga 36.6% për Bashkinë e Vaut të Dejës në 98.1% për Bashkinë e Tepelenës. Mesatarisht buxheti realizohet në masën prej 75.56% dhe 28 bashki kanë një tregues të realizimit të buxhetit nën mesatare. Në këto kushte, stoku i detyrimeve të prapambetura përkundrejt buxhetit të realizuar rritet.


Situata në Bashkinë e Kavajës dhe të Vorës është shumë më serioze ku detyrimet e prapambetura shënojnë respektivisht 91.23% dhe 90.54% të shpenzimeve faktike në vitin 2021. Në këto kushte, bashkitë duhet t'i vlerësojnë me kujdes angazhimet e reja financiare në kushtet e ritmeve të ulta të ekzekutimit të buxhetit.

Tabela nr. 8 Statusi i vështirësisë financiare për Bashkitë 2021 (referuar shpenzimeve vjetore faktike)

Satusi i Vështirësisë	Numri i Bashkive	Bashkia	% e detyrimeve të prapambetura ndaj totalit të shpenzimeve faktike 2021
Pa Probleme Financiare	35	Të gjitha bashkitë e tjera	Nga 0 deri 12.11 %
Me probleme financiare	14	Klos Finiq Kukës Kamëz Pukë Selenicë Berat Tropojë Tepelenë Dibër Konispol Divjakë Peqin Kuçovë	15.96% 16.37% 16.53% 16.55% 16.92% 17.18% 17.18% 17.41% 17.87% 18.79% 21.47% 22.32% 22.50% 25.31%
Në vështirësi financiare	10	Rrogozhinë Lezhë Delvinë Pogradec Dimal Roskovec Poliçan Cërrik Malësi e Madhe Belsh	26.77% 27.71% 28.08% 30.63% 30.95% 36.45% 38.22% 51.44% 68.61% 76.94%
Në vështirësi serioze financiare	2	Vorë Kavajë	90.54% 91.23%

Burimi: Raportimet e Bashkive 2021 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe të dhënat e SIFQ


Grafiku nr.4 Detyrimet e prapambetura përkundrejt shpenzimeve faktike 2021



Burimi: Raportimet e Bashkisë 2021 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe të dhënat e SIFQ

Grafiku nr. 5 pasqyron diferencat mes vitit 2021 e 2020 të përqindjes së detyrimeve të prapambetura përkundrejt shpenzimeve faktike. Vihet re përmirësimi i treguesit të detyrimeve në 2021 për bashkitë e Vorës dhe Roskovecit me një reduktim prej respektivisht 114% dhe 40% nga viti 2020 i përqindjes së detyrimeve ndaj shpenzimeve faktike. Ndërkohë një përkeqësim i rëndësishëm vihet re në bashkitë e Malësisë së Madhe dhe Belshit me një rritje të treguesit në 2021 përkatësisht me 57% dhe 43%. Janë 13 bashki me treguesit e detyrimeve 2021-2020 ndaj shpenzimeve faktike të të cilëve pësojnë përkeqësim (të shënuara me të kuqe në grafikun nr. 5).

Grafiku nr.5 Diferenca e përqindjes së detyrimeve përkundrejt shpenzimeve faktike mes viteve 2021-2020



DETYRIMET E PRAPAMBETURA DHE FONDET E TRASHËGUARA NGA VITI 2021

Qeverisja vendore, në drejtim të menaxhimit të financave publike është një proces i vazhdueshëm, si rrjedhojë veprimet dhe mosveprimet e Kryetarëve të Bashkive në lidhje me krijimin e detyrimeve të prapambetura kanë ndikuar dhe janë mbartur në vite. Në vitin 2021, 61 bashkitë e vendit rezultojnë me një stok detyrimesh të prapambetura të mbar-tura dhe të krijuara rishtazi në vlerën rreth 6.5 miliard lekë.

Konstatohet se krijimi i detyrimeve të prapambetura mund të rezultojë për shkak se menaxhimi financiar në disa bashki është i dobët – bashkitë nuk arrijnë të planifikojnë dhe zbatojnë efektivisht buxhetet e tyre. Kjo tregon mungesë të disiplinës financiare dhe keq menaxhimin e fondeve publike.


Çdo vit buxhetor bashkitë kanë të drejtë të trashëgojnë në buxhetin e vitit pasardhës mjetet monetare të papërdorura nga të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale. E drejta për përdorimin e tyre miratohet në shtesë të buxhetit të vitit pasardhës dhe përdoren si burim financimi për realizimin e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve dhe të mirave publike për qytetarët. Të gjitha bashkitë trashëgojnë në vitin pasardhës mjete monetare të papërdorura nga:

- mosrealizimi i shpenzimeve të planifikuara, kryesisht për investime (objekte investimi të cilat ende nuk janë prokuruar deri në fund të vitit, duke sjelle një diferencë midis faktit dhe planit të shpenzimeve);
- tejkalimi i planit të të ardhurave në disa bashki (e drejta për përdorim e të cilave nuk është miratuar në vitin korrent);
- mospërdorimi i fondeve të transfertës së pakushtëzuar së përgjithshme dhe transfertës së pakushtëzuar sektoriale gjatë vitit buxhetor;
- të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore të arkëtuara në muajin dhjetor të vitit korrent.

Për vitin 2022, mjetet monetare/fondet e trashëguara nga bashkitë rezultojnë kryesisht nga të ardhurat e veta dhe nga transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale e papërdorur gjatë vitit 2021. Mbartja e fondeve të papërdorura në vite, në një vlerë të konsiderueshme rreth **20 miliard lekë** tregon një dobësi në planifikimin e të ardhurave apo menaxhimin e fondeve publike vendore brenda vitit fiskal.

Në Grafikon nr. 125 paraqiten bashkitë sipas vlerës së trashëgimit të fondeve të papërdorura në vitin 2021, të cilat janë pjesë e buxhetit të miratuar për vitin 2022. Konstatohet se bashkia Tiranë trashëgon pjesën më të lartë të tyre rreth 10.6 miliard lekë, më pas vjen bashkia Durrës rreth 1 miliard lekë, bashkia Shkodër 816 milion lekë, bashkia Himarë 584 milion lekë, bashkia Fier 465 milion lekë.

Grafiku nr.125 Fondet e Trashëguara të Buxhetit 2021




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Nëse do të mbajmë në konsideratë madhësinë e bashkisë në terma të popullsisë, në Grafikon nr.125 vëmë re se bashkia e Himarës ka nivelin më të lartë të mjeteve monetare/fondeve të papërdorura në 43 milionë lekë për 1,000 banorë, ndjekur nga Tirana në 16.6 milionë lekë për 1,000 banorë. Mesatarja e fondeve të papërdorura është 5.1 milionë lekë për 1000 banorë dhe vetëm 8 bashki janë mbi këtë mesatare: bashkitë e Gjirokastrës, Malësisë së Madhe, Krujës, Malësisë së Madhe, Mallakastrës, Sarandës, Shkodrës dhe Tiranës. Gjithashtu vëmë re se vetëm bashkia e Malësisë së Madhe si bashki në vështirësi financiare ka mjete monetare/fonde të papërdorura mbi mesataren e bashkive. Bashkitë e tjera me probleme dhe në vështirësi financiare, nuk kanë fonde të papërdorura mbi mesataren e 5.1 milionë lekë për 1,000 banorë.

Nëse krahasojmë fondet e trashëguara me planin e miratuar të buxhetit, rezulton se ato zënë 26% të planit, shifër mjaft e lartë dhe sigurisht tregues jo i mirë i përdorimit të fondeve publike. Rezulton se, disa bashki nuk kanë konsumuar as 50% të planit të buxhetit të tyre. Ndërkohë, nëse trashëgimin e fondeve e krahasojmë me buxhetin faktik rezulton se zë rreth 38% të tij dhe janë disa bashki që shuma e trashëgimeve të fondeve tejkalon gjysmën e buxhetit faktik. Rasti i bashkisë Himarë e cila trashëgon 127% të buxhetit faktik, do thotë se sipas këtyre treguesve trashëgon dhe buxhetin e vitit 2022 (Grafiku nr.126).

Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohen të trashëguara për tu përdorur në vitin 2022 për çdo bashki kundrejt shpenzimeve të planifikuara për vitin 2021 dhe shpenzimeve të realizuara në vitin 2021.

Grafiku nr.126 Fondet e Trashëguara nga 2021
kundrejt Shpenzimeve të Planifikuara dhe ato Faktike në 2021




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Fenomeni i trashëgimit të fondeve është negativ për procesin e mirëmenaxhimit të financave publike në nivel vendor. Fondet e trashëguara duke mos u përdorur sjellin efekte dhe pasoja ekonomiko-financiare, si më poshtë:

- Ndikojnë në rritjen e ekonomike (PBB) pasi shpenzimi i tyre do të nënkuptonte më shumë punësim, më shumë lëndë të para dhe materiale të përdorura, më shumë konsum mallrash dhe shërbimesh;
- Nëse marrim në konsideratë vlerën në kohë të parasë dhe madje edhe efektet negative të luftës në Ukrainë rezulton se mjetet monetare të mbartura amortizohen, pra e ulin vlerën e tyre.
- Këto mjete monetare nëse do të ishin në duart e biznesit dhe të individit mund të ishin shpenzuar apo investuar në sektor fitimprurës dhe jo të rrinin stok dhe duke u zhvlerësuar.

Nëse do t'i referohemi në veçanti bashkive të cilat rezultojnë me probleme financiare për vitin 2021, rezulton se bashkia Pogradec trashëgon ndaj planit të buxhetit 14% të fondeve, ndërkohë që ndaj faktit 20% të fondeve, bashkia Lezhë trashëgon ndaj planit 24% të fondeve dhe ndaj faktit 33%, bashkia Rrogozhinë trashëgon ndaj planit 12% të fondeve dhe ndaj faktit 17% (Grafiku nr. 127).


Grafiku nr.127 Fondet e Trashëguara nga 2021 kundrejt Shpenzimeve të Planifikuara dhe ato Faktike në 2021 për Bashkitë me Probleme Financiare



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në bashkitë me vështirësi financiare, bashkia Malësi e Madhe trashëgon ndaj planit një vlerë të konsiderueshme 36% të fondeve dhe ndaj faktit 48 % të fondeve. Grafikët e mëposhtëm paraqesin situatën e trashëgimit të fondeve të papërdorura në vitin 2021, ndaj shpenzimeve të planifikuara dhe atyre faktike për këto bashki (Grafiku nr. 128).

Grafiku nr.128 Fondet e Trashëguara nga 2021 kundrejt Shpenzimeve të Planifikuara dhe ato Faktike në 2021 për Bashkitë në Vështirësi Financiare




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në këndvështrimin e mësipërm, mospërdorimi me efektivitet i fondeve buxhetore në vitin 2021, mund të ketë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e stokut të detyrimeve të prapambetura dhe paraqitjen e këtyre bashkive me probleme dhe vështirësi financiare.

Nëse do të shikonim diferencën ndërmjet fondeve të trashëguara dhe detyrimeve të prapambetura, vihet re se të gjitha bashkitë me probleme e vështirësi financiare kanë mjete monetare të trashëguara më të vogla se detyrimet e prapambetura, me përjashtim të Bashkisë së Lezhës (Grafiku nr. 129). Përmes një angazhimi serioz për identifikimin e debitorëve dhe ndjekjen e procedurave ligjore, detyrimet e prapambetura reduktohen në të gjitha bashkitë dhe vecanërisht në ato me probleme, apo potencialisht edhe zerohen sikurse është në rastin e Bashkisë së Lezhës.


Grafiku nr. 129 Diferenca Fonde të Trashëguara nga 2021 me Detyrimet e Prapambetura në 2021, '000,000 lekë



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Nëse do të vëzhgonim vetëm bashkitë me status vështirësie me probleme dhe në vështirësi financiare, vihet re se mesatarisht fondet e trashëguara janë 42% të totalit të detyrimeve të prapambetura. Të gjitha bashkitë do kishin përmirësuar statusin e tyre të vështirësisë nëse do ishin përdorur fondet në dispozicion.


Grafiku nr. 130 Përqindja e Fondeve të Trashëguara nga 2021 ndaj Detyrimeve të Prapambetura në 2021 për Bashkitë me Probleme e Vështirësi Financiare



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Një proces shumë i rëndësishëm për bashkitë është faza e hartimit dhe planifikimit të buxhetit vjetor. Në Grafikon nr. 131 paraqitet ndryshimi midis buxhetit të planifikuar dhe atij faktik për bashkitë të cilat rezultojnë me një diferencë të konsiderueshme. Ky grafik, tregon për një planifikim jo efektiv të buxhetit nga disa bashki. Konstatohet se, parashikimi shumë optimist i të ardhurave vendore, shoqërohet me buxhete të paqëndrueshme duke krijuar rreziqe për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Grafiku nr.131 Planifikimi jo Realist i Shpenzimeve Buxhetore për Vitin 2021



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

KONKLUZIONE/ REKOMANDIME

KONKLUZIONE

- Konstatohet se krijimi i detyrimeve të prapambetura mund të rezultojnë për shkak se menaxhimi financiar në disa bashki është i dobët – bashkitë nuk planifikojnë në mënyrë realiste të ardhurat e tyre dhe/apo zbatojnë efektivisht buxhetet e tyre. Kjo tregon mungesë të disiplinës financiare dhe keq menaxhim të fondeve publike.
- Stoku i detyrimeve të prapambetura deri në fund të dhjetorit 2021 për njësitë e vetëqeverisjes vendore është 6.5 miliardë lekë (6,463,655,523 lekë). Nisur nga impakti financiar në detyrimet financiare të qeverisjes së përgjithshme, një vëmendje të veçantë merr (i) rëndësia që Këshilli i Vetëqeverisjes Vendore dhe Kryetari i Bashkisë duhet t'i kushtojë menaxhimit të borxhit të prapambetur, planifikimit realist të të ardhurave dhe kujdesit në marrjen përsipër të angazhimeve të reja, si dhe (ii) domosdoshmëria e monitorimit të ngushtë deri në kontroll direkt të angazhimeve publike që duhet të ushtrojë Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkitë që rezultojnë me vështirësi financiare deri në paaftësi paguese.
- Për vitin 2021, rezulton se shtatë bashki kanë një status si njësi në vështirësi financiare, konkretisht bashkitë: Roskovec, Poliçan, Cërrik, Malësi e Madhe, Vorë, Belsh e Kavajë. Dhjetë bashki kanë probleme financiare: Peqin, Tropojë, Tepelenë, Rrogozhinë, Konispol, Lezhë, Kuçovë, Pogradec, Delvinë e Dimal. 44 bashki të tjera nuk kanë probleme financiare.
- Përmendim veçanërisht një performancë shumë të mire të bashkive Gjirokastrë, Pustec, Këlcyrë, Shkodër dhe Korçë me 0-1% detyrime të prapambetura, performance relativisht të mirë të 39 bashkive të tjera ku veçojmë bashki të mëdha si Tirana, Elbasani dhe Vlora me stok më të vogël se 5% të detyrimeve të prapambetura përkundrejt shpenzimeve të miratuara. Vihet re se bashkitë që paraqiten me probleme financiare apo janë në vështirësi financiare janë më së shumti bashkitë me shpenzime të planifikuara për frymë për vitin 2021 nën mesataren prej 21,306 lekë për banorë.
- 41 bashki e kanë ulur stokun e detyrimeve në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020. Bashkia e Këlcyrës, Vorës, Dimal, Poliçanit dhe Tepelenës kanë përmirësuar statusin e vështirësisë financiare në 2021, duke reduktuar stokun më shumë se 10%. Bashkia e Këlcyrës rezulton nga një bashki në vështirësi financiare në një bashki pa probleme financiare me asnjë detyrim të prapambetur. Nëntë bashki të tjera kanë përmirësuar statusin e tyre përmes një reduktimi të stokut me më shumë se 5%. Bashkia e Dibrës, Kukësit dhe Finiqit në tre vitet e fundit kanë përmirësuar statusin nga bashki me vështirësi financiare në bashki pa probleme financiare. Bashkia e Pogradecit ka përmirësuar statusin nga bashki në vështirësi financiare në bashki me probleme financiare. Stoku i detyrimeve është reduktuar me më pak se 5% për 26 bashki të tjera.

- 16 bashki e kanë rritur përqindjen e stokut të detyrimeve në vitin 2021. Për 12 bashki stoku i detyrimeve është rritur deri në 5% dhe për Bashkinë e Maliqit stoku është rritur me 6%. Statusi i vështirësisë financiare është përkeqësuar për bashkinë e Roskovecit dhe të Peqinit duke u klasifikuar si bashki në vështirësi financiare në vitin 2021. Stoku i detyrimeve financiare është rritur më shumë se 10% për tre bashki. Statusi i vështirësisë financiare është përkeqësuar për Bashkinë e Cërrikut nga një bashki me probleme financiare në një bashki në vështirësi financiare. Statusi i vështirësisë financiare është përkeqësuar shumë për Bashkinë e Belshit nga një bashki pa probleme financiare në 2019 në një bashki në vështirësi financiare me rritje të ndjeshme nga viti 2020. Gjithashtu, statusi i vështirësisë financiare është përkeqësuar edhe për bashkinë Malësi e Madhe nga një bashki pa probleme financiare në vitin 2020 në një bashki me vështirësi financiare në vitin 2021.
- Në lidhje me strukturën e detyrimeve të prapambetura, vihet re se rreth 9% janë të natyrës së vendimeve gjyqësore, 56% e tyre janë të natyrës së shpenzimeve për investime dhe rreth 35% janë për shpenzime të tjera korrente. Në dallim nga viti 2020, vihet re një reduktim të detyrimeve për vendime gjyqësore dhe rritje e detyrimeve të natyrës së shpenzimeve të tjera korrente.
- Shumica e bashkive me detyrime mbi 15% ndaj shpenzimeve të miratuara kanë më shumë detyrime të natyrës së shpenzimeve kapitale, me përjashtim të bashkive të Tepelenës, Konispolit, Lezhës, Pogradecit dhe Kavajës. Bashkia e Pogradecit ka përqindjen më të lartë të detyrimeve për vendime gjyqësore (31.14%), edhe pse të përgjysmuar nga treguesi në vitin 2020 (65.27%). Bashkia e Lezhës gjithashtu ka shlyer pjesën më të madhe të detyrimeve të vendimeve gjyqësore, nga 38.09% në 2020, në 0.37% në 2021.
